



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE 2026

Lënda: Qytetari dhe Psikologji

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me **zhvillim dhe arsyetim**.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7
Pikët							
Pyetja	8	9	10	11	12	13	14
Pikët							
Pyetja	15	16	17	18	19	20	21
Pikët							
Pyetja	22	23	24	25	26	27	28
Pikët							
Pyetja	29	30	31	32	33		
Pikët							

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. Anëtar

2. Anëtar

Qytetari

1. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë dhe ndodhet në majë të piramidës së normave juridike. Kushtetuta vepron si ligji suprem mbi të gjitha ligjet e tjera në vend. Ky parim lidhet me: **1 pikë**
 - A) pluralizmin.
 - B) sovranitetin.
 - C) parimin e barazisë.
 - D) kushtetutshmërinë.

2. Në sistemet demokratike, çdo person i nënshtrohet të njëjtave ligje, si në të drejtën për mbrojtje, ashtu edhe në përgjegjësitë ligjore, pavarësisht karakteristikave personale, si raca, gjinia, etj. Ky përshkrim lidhet me parimin e: **1 pikë**
 - A) pluralizmit politik.
 - B) barazisë përpara ligjit.
 - C) ndarjes së pushteteve.
 - D) kontrollit të pushteteve.

3. Demokracia përfaqëson një sistem qeverisjeje që përfshin praktikën e proceseve vendimmarrëse bazuar në një sistem vlerash si ndarja e pushteteve, liria e votës, bashkëpunimi, toleranca, barazia etj. Ky përshkrim lidhet me vlerat: **1 pikë**
 - A) morale.
 - B) sociale.
 - C) politike.
 - D) ekonomike.

4. Rishikimi i kushtetutës për të reflektuar ndryshimet e nevojshme që lidhen me zhvillimet sociale, politike, ekonomike, etj., është i rëndësishëm.
Përcaktoni alternativën e saktë, bazuar në pohimin e mësipërm. **1 pikë**
 - A) Vetëm kushtetutat e ngurta mund të ndryshojnë.
 - B) Kushtetuta siguron qëndrueshmëri, ndaj është e pandryshueshme.
 - C) Ndryshimet në kushtetutë ndodhin në përputhje me ndryshimet shoqërore.
 - D) Ndryshimet në kushtetutë ndodhin çdo herë që ka ndryshim të forcës politike në pushtet.

5. “Të drejtat e njeriut që ne gëzojmë sot u fituan përmes luftës së pakicave që refuzuan të pranonin të ecnin me turmën.” Kjo shprehje na tregon se të drejtat e njeriut formohen nga betejat e grupeve të caktuara për të sjellë ndryshime në shoqëri.
Ky pohim mbështet faktin se të drejtat e njeriut: **1 pikë**
 - A) nuk janë dinamike.
 - B) janë në evolucion, në varësi të nevojave.
 - C) kufizohen plotësisht në kushte të caktuara.
 - D) lindin bashkë me njeriun dhe nuk ndryshojnë.

6. Era ka filluar të ndjekë një regjim ushqimor të kujdesshëm për marrjen e vlerave ushqyese ditore dhe për një hidratim të mirë gjatë ditës. Së bashku me mikeshat e saj, ajo ushtrohet rregullisht në aktivitete gjimnastike.
Regjimi që po ndjek Era ndikon kryesisht në komponentin e shëndetit: **1 pikë**
 - A) fizik.
 - B) social.
 - C) mendor.
 - D) emocional.

7. Prej dhjetorit të vitit të kaluar deri në janar të 2025 është ndaluar peshkimi i koranit në liqenin e Pogradecit, pasi përkon me periudhën e riprodhimit të tij. Me cilin objektiv të mbrojtjes së mjedisit lidhet drejtpërdrejt ky vendim që ndikon në rikuperimin e rezervave të peshkut? **1 pikë**

- A) Kontrollin dhe pakësimin e ndotjes së ujit.
- B) Ruajtjen e biodiversitetit dhe përdorimin racional të burimeve.
- C) Pjesëmarrjen e publikut në veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit.
- D) Rritjen e zhvillimit ekonomik dhe garantimin e burimeve energjetike rinovuese.

8. Joni është një shofer i ri. Ai sapo pa një tabelë në të cilën shkruhej emri i një qyteti, që identifikon lokalitetin e arritur. Kjo tabelë përfaqëson një sinjal rrugor: **1 pikë**

- A) rreziku.
- B) ndalimi.
- C) tregues.
- D) detyrimi.



9. Sinjali i vendqëndrimit për autoveturat në shërbim publik tregon një zonë qëndrimi për përdorim vetëm nga mjetet taksi. Përcaktoni në cilën kategori bën pjesë ky sinjal. **1 pikë**

- A) Sinjalet e rrezikut
- B) Sinjalet urdhëruese
- C) Vertikale, treguese
- D) Urdhëruese të përparësisë



10. Drini është banor i katit të parë dhe në mbledhjen e Asamblesë së Bashkëpronarëve, ai dha disa ide për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të përbashkëta. Këto propozime krijuan debate të gjata. Për këtë situatë është i vërtetë pohimi: **1 pikë**

- A) Drini si banor i pallatit, nuk mund të jap propozime.
- B) Drini ka të drejtë të sugjerojë propozime në Asamble.
- C) Drini si banor nuk ka të drejtë të marrë pjesë në këto mbledhje.
- D) Asambleja nuk pranon sugjerime, vetëm miraton tarifën e administrimit.

11. Një kontratë pune është një akt ligjor dypalësh që rregullon marrëdhëniet punëdhënës-punëmarrës. Kontrata shërben për të mbrojtur interesat e palëve duke ofruar një kornizë të qartë për marrëdhënien e punës. Listoni katër elementë përbërës që përfshihen në kontratë. **4 pikë**

- 1) _____
- 2) _____
- 3) _____
- 4) _____

12. Kushtet në vendin e punës kanë ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien, sigurinë, motivimin dhe produktivitetin e punonjësve. Shpjegoni tre kushte që garantohen sipas ligjit dhe janë të domosdoshme për punonjësit në ambientin e punës, për të siguruar një mjedis të shëndetshëm dhe efektiv. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

13. Në kuadër të një projekti ndërlëndor, nxënësit e klasave të dhjeta do të marrin pjesë në një konkurs. Ata do të dorëzojnë ese me argumente pro ose kundër lidhur me mosbindjen civile si një formë e protestës politike. Cilin funksion realizon shkolla në këtë rast? **1 pikë**

Shpjegoni tre aspekte që tregojnë për rëndësinë që ka organizimi i këtij aktiviteti për nxënësit. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

14. Për secilën nga situatat e mëposhtme, dalloni cilës kategori (brez) të drejtash i përket. **3 pikë**

Marrëveshja për ndalimin e peshkimit në Oqeanin Arktik për një periudhë 16-vjeçare, synon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ruajtjen e specieve nënujore. _____

Për një nivel jetese të përshtatshëm dhe me dinjitet është përcaktuar të ndërmerren reforma për rritjen e pagave në vend. _____

Një forcë e re politike kërkon të regjistrohet në gjykatë dhe të marrë pjesë si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë dhe për organet e qeverisjes vendore. Për këtë qëllim po ndjek hap pas hapi çdo procedurë ligjore. _____

15. Në shoqërinë e sotme, revolucioni i informacionit, ka rritur mundësinë e ushtrimit të së drejtës së informimit, por gjithashtu paraqet edhe kufizime. Shpjegoni dy mundësi dhe një kufizim në lidhje me informimin. **3 pikë**

Mundësi

- 1) _____

- 2) _____

Kufizim

- 1) _____

16. Industria e modës së shpejtë ndikon në rritjen e emetimeve vjetore të karbonit. Kjo industri lidhet me një metodë prodhimi dhe marketingu që synon prodhimin e shpejtë të shumë veshjeve. Moda e shpejtë po inkurajon konsumin përtej nevojave, e nxitur edhe nga çmimet e përballueshme, që janë rezultat i kushteve të papërshtatshme të punës për punonjësit e fasonerisë.


Përshkruani tri përgjegjësi të konsumatorit, të cilat duhet t'i vlerësojë kur bën blerje. **3 pikë**

- 1) _____

- 2) _____

- 3) _____

Psikologji

17. Arlindi po luan një videolojë që kërkon përqendrim të lartë dhe reflekse të shpejta. Ai kryeson renditjen dhe tashmë që është drejt përfundimit ndjen se zemra i rreh fortë dhe frymëmarrja i përshpejtohet. Hormoni që çlirohet për të përgatitur organizmin në këtë situatë është: **1 pikë**
- A) insulina.
B) tiroksina.
C) glikogjeni.
D) adrenalina.
18. Në festat e nëntorit Vesa u vlerësua për performancën e saj në disa valle që kërkonin ekuilibër, realizimin e koordinuar dhe sinkronizuar të lëvizjeve komplekse. Në këtë rast luan rol të rëndësishëm: **1 pikë**
- A) truri i vogël.
B) hipotalamusi.
C) hemisfera e majtë.
D) formacioni retikular.
19. Hana ndihet e stresuar dhe e pamotivuar në punë; ajo po shqyrton mundësi të tjera në zhvillimin e karrierës së saj. Psikologjia e drejtimit kognitivist në takimet me Hanën ka prioritet: **1 pikë**
- A) eksplorimin e përvojave të mëparshme për shenja të traumës.
B) realizimin e hipnozës, si teknika që ndihmon më mirë për situatën.
C) identifikimin e modeleve negative të mendimit që lidhen me mungesën e motivimit.
D) zbatimin e një orari të përpiktë për realizimin e detyrave, për përvetësimin e sjelljeve të reja.
20. Në vlerësimin e personalitetit, psikologjia i paraqiti klientit A.L disa figura të paqarta dhe i kërkoi të shprehte se çfarë shihte në to. Instrumenti që është përdorur për të vlerësuar personalitetin e klientit është: **1 pikë**
- A) intervista.
B) testi objektiv.
C) testi projektiv.
D) regjistrimi i proceseve fiziologjike.
- 
21. Bazuar në teorinë psikoanalitike të Frojdit, personaliteti njerëzor përbëhet nga tri struktura. Cila strukturë përfaqëson sistemin racional që ndërmjetëson midis impulseve për kënaqësi të menjëhershme dhe standardeve morale të shoqërisë? **1 pikë**
- A) Idi
B) Ego
C) Superego
D) Represioni
22. Arkitektët kanë aftësinë për të formuar imazhe mendore (vizualizuar) abstrakte të strukturave shumëdimensionale, duke integruar në mënyrë efektive aspektet funksionale dhe estetike. Bazuar në teorinë mbi inteligjencën njerëzore të Gardnerit, kjo aftësi lidhet me inteligjencën: **1 pikë**
- A) kinestetike.
B) hapësinore.
C) natyralistike.
D) logjike–matematikore.

23. Për festën e Pavarësisë, Kroj kishte përgatitur dy vjersha, të cilat i recitoi në kopsht. Sapo përfundoi së recituar vjershën e parë, mësueset e shokët buzëqeshën dhe e duartrokitën fort. Kësaj here, Kroj u ngut të recitojë edhe më shpejt vjershën tjetër.

Reagimi i Kroit në këtë situatë lidhet me:

1 pikë

- A) kushtëzimin e ikjes.
- B) përforcuesit parësorë.
- C) përforcuesit dytësorë.
- D) kushtëzimin shmangës.

24. Trajtimi i sjelljes jonormale është specifik për drejtimet e ndryshme psikologjike. Analiza e ëndrrave, për ta bërë pacientin të ndërgjegjësohet për mënyrën e funksionimit të botës së tij të brendshme, përdoret nga drejtimi:

1 pikë

- A) biologjik.
- B) humanist.
- C) bihejviorist.
- D) psikoanalitik.

25. Menaxherët e shitjes janë ekspertë të ndikimit social. Ata zotërojnë artin e komunikimit dhe negocimit. Për të arritur qëllimin e tyre, përdorin teknika të ndryshme si ulje çmimesh, mundësi për të provuar produktin falas, etj. Me cilin koncept të ndikimit social lidhet ky rast?

1 pikë

- A) Obediencën
- B) Paragjykimin
- C) Kompliancën
- D) Konformizmin

26. Problemet e sjelljes dhe shëndetit mendor, kërkojnë trajtim profesional. Trajtimi bihejviorist bazohet në:

1 pikë

- A) asosacionet e lira dhe analizën e ëndrrave.
- B) empatinë dhe përpjekjen për zhvillim të vazhdueshëm.
- C) zgjidhjen e konflikteve të brendshme nga përvojat e hershme.
- D) mësimin e sjelljeve të reja përmes shpërblimit ose ndëshkimit.

27. Nxënësit e klasës së nëntë ndoqën prezantimin e projektit mbi librin "Unë jam Malala", shoqëruar edhe me një ekspozitë pikturash. Në përfundim të prezantimit, nxënësit u përfshinë në një diskutim, ku parashtruan shumë pyetje. Nxënësit reflektuan dhe arritën të bënin një analogji midis mesazhit të librit dhe vendosmërisë për t'u përballur me vështirësi të ndryshme në jetë, pa u dorëzuar.

Sipas psikologut Piazhe, në cilin stad të zhvillimit janë nxënësit?

1 pikë

Bazuar në rastin e dhënë, shpjegoni dy aspekte që tregojnë stadin në të cilin ndodhen nxënësit.

2 pikë

1) _____

2) _____

Shpjegoni rëndësinë që ka ky stad në zhvillimin personal të individit për jetën.

1 pikë

28. Psikologë nga tre drejtime të ndryshme të studimit të psikologjisë kanë trajnuar mësuesit për të krijuar një disiplinë pozitive në klasë.

Bazuar në këshillat e psikologëve, përcaktoni drejtimin psikologjik që përfaqëson secili.

3 pikë

“Mbështetni nxënësit emocionalisht në mënyrë që të zhvillojnë potencialin e tyre, duke krijuar një mjedis në të cilin ata të ndihen të respektuar, të sigurt dhe të motivuar. Dëgjojini pa i paragjykuar, për të kuptuar më mirë sjelljet e tyre.” _____

“Komunikoni qartë rregullat dhe pasojat. Përdorni lavdërime specifike dhe shpërblime simbolike për të inkurajuar sjellje pozitive si zbatimi i rregullave, etj. Sjelljet e nxënësve do të ndikohen nga mjedisi rrethues.” _____

“Mësojini nxënësve aftësi socio-emocionale si: njohja e emocioneve, menaxhimi i zemërimit dhe zgjidhja e konflikteve. Nxënësit nxiten nga mendimet për t'u përfshirë në sjellje të caktuara, ndaj është e rëndësishme të ndikojmë në mendimet e ndjenjat e tyre për rezultate më të mira.” _____

29. Emocionet ndikojnë në mënyrën se si mendojmë, ndiejmë, marrim vendime, ndërveprojmë me të tjerët dhe përballojmë situata të ndryshme jetësore. Duke u bazuar në rolin që emocionet kanë në aspektin psikologjik dhe social të njeriut, shpjegoni tre përbërës të emocioneve:

3 pikë

nxitshmëria fiziologjike: _____

përbërësi sjellor: _____

përbërësi kognitiv: _____

30. Shpjegoni burimin e stresit për situatat e mëposhtme:

2 pikë

Një çift i ri i sapomartuar presin të bëhen prindër së shpejti. Ata janë zhvendosur për një jetë të re në një qytet tjetër dhe po përballen me mungesën e të ardhurave për shkak të papunësisë së bashkëshortit. Këto ndryshime u kanë rritur përgjegjësitë dhe po u shkaktojnë stres.

Besa sapo ka nisur studimet master për shkenca kompjuterike, ndërkohë që i është ofruar një mundësi punësimi me një pagë shumë të mirë. Ajo ndihet e stresuar për të marrë një vendim pasi mendon se eksperiencia e punës është e rëndësishme, por edhe realizimi i studimeve është i nevojshëm për kualifikimin e saj profesional.

31. Njerëzit në ditët e sotme përballen çdo ditë me kërkesa të vazhdueshme sociale, profesionale për të qenë të gatshëm, bashkëpunues, produktivë dhe të suksesshëm. Këto kërkesa shpesh krijojnë mbingarkesë mendore duke ndikuar në mirëqenien psikologjike. Vlerësoni dy strategji për përballimin e stresit personal.

2 pikë

1) _____

2) _____

32. Humanizmi nxit ndjenjën e përgjegjësisë së përbashkët për të kultivuar mirëkuptim, barazi dhe respekt, bazuar në vlerat dhe aspiratat tona të përbashkëta. Nobelisti Tutu shprehej: *“Humanizmi im është i lidhur me humanizmin tënd, prandaj ne mund të jemi njerëzorë vetëm së bashku.”*

Analizoni tri mënyra që ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis njëri-tjetrit duke demonstruar qëndrime tolerance. **3 pikë**

1) _____

2) _____

3) _____

33. Psikologët kanë përcaktuar tre tipe të kujtesës, duke u bazuar në llojin e informacionit që ruhet në kujtesë. Përcaktoni llojin e kujtesës, bazuar në informacionin e mëposhtëm. **3 pikë**

Kur sheh fotot e diplomimit, Lura kujton emocionet e forta që përjetoj kur mbajti fjalimin e saj përpara gjithë studentëve dhe stafit akademik. _____

Albi jeton në Romë. Më 21 maj, Ditën Botërore të Diversitetit Kulturor, ai prezantoi elementë të kulturës shqiptare në klasë. _____

Edhe pse kishin kaluar vite nga hera e fundit në pistën e skive, Ema rëshqiste pa problem, ruante ekuilibrin duke anuar trupin herë në njërin krah e herë në tjetrin, pa vështirësi. _____